



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 286/1 Prot.

Tiranë, më 24/03/2015

Lënda: Dërgohet Vendimi Nr. 36, datë 24/03 /2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Drejtuar: Z. Ilir BUREL,
Drejtor, Drejtoria Shëndetit Publik Mat,
Lagjja: "Drita"
Rruga: "Ibrahim Temo"
BURREL

Znj. Ilir BUREL,
Lagjja: "Pjetër Budi",
BURREL

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin Nr. 36, datë 24/03 /2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Commissioner for Protection from Discrimination

Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 36, Datë 24 / 03 / 2015

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj. [] me Nr. Regjistri 111, datë 01. 12. 2014, kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të "Bindjes Politike".

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATON:

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ankesa e paraqitur nga ankuesja, znj. [], është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Subjekti ankues deklaron se: "Ka qenë e punësuar pranë DSHP Mat që nga muaji Nëntor 2012, me detyrë specialiste finance. Me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014 është urdhëruar nga ish Drejtori z. [] për largimin e menjëhershëm politikisht nga puna. Znj. [] shpjegon se prej gjashtë muajsh ndodhej përballë presionit të titullarit i cili pa asnjë referencë ligjore por për motive të pastra politike ka bërë largimin e saj nga puna. Mbështetur në vendimin nr. 140, datë 22.09.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në shkresës nr. 460, datë 04.11.2014 të Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, znj. [] është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, specialiste finance. Znj. [] sqaron se është paraqitur në punë më datë 12.11.2014 dhe nuk ka marrë në dorëzim detyrën e saj nga ana e punonjësit z. []. Për mëtejshme, ankuesja pretendon se nga ana e drejtuesit të institucionit, nuk janë firmosur shkresat e hartuara prej saj, lidhur me pagën neto të kërkuar nga punonjësit. Me shkresën nr. 493 prot., datë 25.11.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, ka njoftuar znj. [] për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara. Arsyeja e e njoftuar për lagimin nga puna, është dëmi ekonomik i shkaktuar institucionit për sistemin e pagave, konstatuar nga Auditimi i ushtruar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Referuar Raportit të Auditit, znj. [] sqaron se ndaj

saj nuk është rekomanduar asnjë masë disiplinore, por shlyerja e dëmit ekonomik që ka sjellë ndaj DSHP Mat”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rikthimin në vendin e punës.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bindja politike, është shkak për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me bindjen politike.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Më datën 03.12.2014, me shkresën nr. 1019/1 prot, është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Drejtorinë e Shëndetit Publik Mat në lidhje me ankesën për pretendim për diskriminim të znj.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32, pika 2 “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.

Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të plotë të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke dërguar vetëm procedurën e largimit nga puna të znj.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara, Komisioneri vlerëson se:

Znj. është punësuar pranë subjektit, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, me shkresën Vendim-Emërimi, nr. 2, datë 14.11.2012 në detyrën e Shefit të Financës për një periudhë 3-mujore. Me shkresën, Vendim-Emërimi, nr. 1, datë 15.01.2013, znj. është emëruar në një afat të pacaktuar.

Referuar Raportit Final nr. 1783/6 prot., datë 04.06.2014, të Auditimit të kryer nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, vërehet se Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat i janë caktuar 24 rekomandime, lidhur me shkeljet e konstatuara në këtë institucion. Ndër të tjera **Auditi i Brendshëm i Ministrisë së Shëndetësisë ka rekomanduar për znj. dhe 4 (katër) punonjës të Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, të arkëtojnë në buxhetin e shtetit shumat për të cilat atyre u janë gjetur shkelje. Në asnjë nga rekomandimet e lëna nga ana e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ishte përcaktuar asnjë detyrim për largimin e punonjësve të cilët janë gjetur në shkelje.** Nga dokumentacioni i dhënë nga ana e ankueses, rezulton se ajo është e vetmja punonjëse e larguar, për shkak të shkeljeve të konstatuara, ndërsa 4 (katër) punonjësit¹ e tjerë vijojnë ende të punojnë pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat për punonjësit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi nga Auditit, por nga ana e këtij institucioni nuk u dërgua asnjë informacion mbi këtë fakt.

Njohja me veprimtarinë politike të subjektit ankues vërtetohet me anë të dokumenteve të paraqitura nga znj. që janë: Vërtetimi si anëtare e subjektit politik Partia Demokratike dhe autorizimi në cilësinë e vëzhgueses për subjektin Partia Demokratike gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 23.06.2013.

Punëdhënësi, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e subjektit ankues dhe të vërtetojë se trajtimi ndryshe i saj ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të znj. Përkundrazi me shkresën nr. 167, datë 20.05.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat urdhëron: **“Largimin e menjëhershëm të znj. politikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik Mat. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë”**. Pas largimit nga puna znj. i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me ankesën nr. 56, datë 20.06.2014. Mbështetur në vendimin nr. 140, datë 22.09.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në shkresës nr. 460, datë 04.11.2014 të Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, znj. është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, specialiste finance. Në përfundim, referuar informacionit të përcjellë nga ankuesja, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, pas vendimit të dhënë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, edhe pse e ka rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, ankueses nuk i është dorëzuar detyra nga ana e punonjësit të cilin zëvendësojë, si dhe nga drejtuesi i këtij institucioni nuk është firmosur asnjë shkresë e hartuar prej saj.

¹ Z. Z. D., aktualisht Shef i Epidemiologjisë, pranë DSHP Mat, ndërsa Znj. M. L., Znj. F. K., Z. S. K., në të njëjtin pozicion pune që kanë qënë më parë.

Me shkresën nr. 493 prot., datë 25.11.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, ka njoftuar znj. Molla, *për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara*. Me urdhërin nr. 21, datë 01.12.2014, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat ka urdhëruar *zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme e të justifikuar* për shkak të dëmit ekonomik të shkaktuar prej saj, ndaj institucionit, fakt i konstatuar nga Auditimi i ushtruar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Referuar të gjithë provave të paraqitura nga palët, si dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, Komisioneri e gjen të pabazuar faktin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës së znj. Molla, dhe ka bindjen se kjo masë është dhënë në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze, kjo bazuar në mungesën e një arsytimi nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18/2 se: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, *bindjet politike*, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Për më tepër ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimin e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohet diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe që ka lidhje me: c) *“trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: *“trajtimi i disfavourshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se shkeljet ligjore të sipërcituara, përbëjnë diskriminim në fushën e punësimit pasi cenojnë të drejtën e punëmarrësit për një trajtim të drejtë dhe jo diskriminues.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve të ndërmarra nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat në dëm të ankueses, krahasuar me punonjësit e tjerë, kanë sjellë për pasojë vendosjen e saj në kushte të disfavourshme dhe diskriminuese, në formën e diskriminimit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12, pika 1/c, nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10, 11, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të znj. **Alca** nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e znj. **Alca** në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

